



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 71/2017**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI  
VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në nenin 49, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ilir META**

Miratuar në datën 27.4.2017

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Numri CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 347, datë, 11.12.2006, faqe 1-118.